



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:132582

Datë: 03.06.2020

Numri i dokumentit: 00941068

P.nr.101/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, në çështjen penale kundër te pandehurit S. Xh. nga fshati S. i U. komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale ga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.797/15, dt.04.04.2017, në mbështetje të nenit 363 par .1, pika 1.3 te KPPK-ës, me dt.03.06.2020, merre këtë;

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë PP.II.nr.797/15, dt.04.04.2017, dhe Pushohet procedura penale kundër të pandehurit S. Xh., nga fshati Stanovc i U. komuna Vushtrri, i lindur me ..., ne fshatin Ll. komuna e Podujeves tani me banim ne fshatin S. komuna Vushtrri, dhe me numër personal te letërnjoftimit ..., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, sipas nenit 106 par.1 nën par 1.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barre mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike të e realizoj në kontest civil-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë Departamenti i përgjithshme ka ngritur Aktakuzë PP.II.nr.797/15, dt.04.04.2017, kundër të pandehurit S. Xh. nga fshati S. i U. komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Lënda penale ndaj te pandehurit i është dorëzuar ne pune gjyqtarit te çështjes me dt.17.10.2017. Gjykata ka caktuar disa seanca ne këtë çështje penale, por qe për shkak te pandemisë globale, përhapjes se virusit covid19, dhe ndërprerjes se punës se rregullt te gjykatave si në ne vendimin e **KGJK.nr.53/2020 të 15.03.2019**, ka qenë e pa mundur që lënda te përfundohet.

Pas rifillimit te punës se gjykatave nga dt. 01.06.2020 me dt. 03.06.2020, gjatë përgatitjes paraprake është shqyrtuar lënda dhe është konstatuar se ne mbështetje të dispozitave nga neni

106 par.1.nën par 1.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndalohet ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të pandehurit, pasi që kanë kaluar afatet e caktuara ligjore nga koha e kryerjes së veprës së supozuar penale, pasi që kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes, çka në rastin konkret për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale pasi që kanë kaluar gjashtë (6) vite dhe se dënimi për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, është se kryerësi dënohet me gjobë dhe deri në tre vjet burgim, kurse dispozita e nenit 106 par.1 të KPRK-së, “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet si me poshtë pika 1.5 tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim;”.

Sipas nenit 107 par. 8 i po këtij neni është përcaktuar se: Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, që në rastin konkret kanë kaluar mbi gjashtë (6) vite. Gjithashtu sipas nenin 107 par.8 të KPRK-së siç u konstatua me sipër “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), andaj sa i përket kohës kur dyshohet se i pandehuri të ketë kryer këtë veprë penale dt.03.06.2014, e deri me dt. 03.06.2020, kanë kaluar gjashtë vite gjë që në këtë rast penal kemi parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekës penale, duke vlerësuar se parashkrimi është një rrethane e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale ndërsa mbi bazën e këtyre arsyeve vendosi që të refuzoi akuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, e refuzon akuzën dhe e pushon procedurën e mëtutjeshme penale ndaj të pandehurit dhe atë duke u bazuar në nenin 106 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-se

Udhëzimin e të dëmtarit në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e muarrë duke u bazuar në nenin 463 të KPP-es.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRI

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.101/17, te dt.03.06.2020

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tri) ditësh prej ditës së pranimit përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.